

Data _____.____.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Shërbime – Procedure e Hapur

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Upgrade Oracle JDE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Shërbimet e teknologjisë së informacionit – 72222300-0;
- Mirëmbajtja e softwareve të teknologjisë së informacionit – 72267100-0.

VLERA E FONDIT LIMIT: 14.959.147.03 *(katërmbëdhjetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dyzet e shtatë, presje zero tre) lekë, pa TVSH.*

AFATI I EKZEKUTIMIT: 6 (gjashtë) muaj nga lidhja e kontrates
(Operatori Ekonomik Fitues do të kryejë Mirëmbajtje (1 vit) nga momenti i marrjes në dorezim të projektit)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor – Autoriteti Portual Durrës – ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas shtojcës 9, pika 2 “Kriteret e perzgjedhjes se ofertuesve” dhe shtojcës 10 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një me vlerë të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllëgaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Si dëshmi për përvojën e mëparshme Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jete i pajisur dhe të paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO-ve, (te perkthyer ne shqip dhe te noterizuara) te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte.

- a) ISO 9001:2015 ose ekuivalente Per menaxhimin e cilesise, qe ka lidhje me objektin e prokurimit.
- b) ISO 27001:2022 ose ekuivalente Per menaxhimin e sigurise se informacionit, qe ka lidhje me objektin e prokurimit.
- c) ISO 20001:2018 ose ekuivalente për Menaxhimin e Shërbimeve TI qe ka lidhje me objektin e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Duke qene se sistemi pjese e prokurimit eshte e rendesishme per sigurine dhe vijueshmerine e punes te sistemeve kritike ne APD duhet qe subjektet zbatuese te kontrates te jene te pajisura me keto certifikime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

- Përmbushja e standartit ISO 9001:2015 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.
- Përmbushja e standartit ISO 27001:2018 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar që shoqëritë zoterojnë njohuritë si dhe procedurat e menaxhimit të sigurisë së informacionit që kerkohen. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të sigurisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të sigurisë.
- ISO 20001:2018 ose ekuivalente është i rëndësishëm se siguron që operatori ekonomik ka procese të strukturuar dhe të certifikuar për menaxhimin profesional të shërbimeve TI, duke siguruar cilësi, vazhdimësi, transparencë dhe besueshmëri në ofrimin e tyre. Ai gjithashtu minimizon rreziqet operationale dhe siguron që shërbimet të jenë në përputhje me nevojat e klientëve.

2.3.3 Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar për territorin e Shqipërisë për produktet e kerkuara. Autorizimi duhet të lëshohet në drejtim të APD dhe në të duhet të ketë informacion të mjaftueshëm për verifikimin e tij. Gjithashtu të vërtetohet dhe lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit në rastin kur autorizimi jepet nga distributori i autorizuar. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën e Partneritetit nga prodhuesi i produkteve.

Argumentimi:

Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kerkohen në këtë prokurim, garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanton që produktet që kerkohen të blihen janë prodhuar/krijuar sipas standardeve të larta nga prodhues të njohur zyrtarisht. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për të garantuar që Operatori Ekonomik ka mbështetjen dhe suportin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për territorin e Shqipërisë për të garantuar cilësinë e produkteve dhe furnizimin e tyre në kohë për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e pajisjeve në kushtet e garancisë dhe pas saj.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pikë 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të vërtetohet që ka të paktën **5 (pesë)** Inxhinier/Specialist të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike dhe/ose Inxhinieri Informatike dhe/ose Teknologji

Informacioni dhe/ose Informatikë dhe/ose Informatikë Matematikë dhe/ose Informatike, Informatikë Ekonomike, Telekomunikacion, Inxhinieri Telekomunikacion që do të angazhohen në implementimin e projektit, ku të vërtetohet nëpërmjet: diplomës.

Argumentimi:

Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika (4) të LPP, ku parashikohet se "4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie." si dhe nisur nga rëndësia e këtij projekti, i cili përveç veprimtarisë funksionale të tij ka impakt të drejtëpërdrejtë në një numër shumë të lartë sistemesh të tjera të cilët ofrojnë shërbime për qytetarët dhe bizneset.

Ky kriter është i domosdoshëm sepse projekti që do të implementohet kërkon ekspertizë të lartë profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit, elektronikës dhe telekomunikacionit. Pjesëmarrja e të paktën 5 inxhinierëve/specialistëve të diplomuar garanton se operatori ekonomik ka kapacitetin njerëzor minimal për të mbuluar të gjitha fazat e projektit, nga projektimi dhe konfigurimi teknik, deri tek implementimi, testimi dhe mirëmbajtja.

2.3.5 Për të vërtetuar aftësitë dhe kapacitetet teknike të punonjësve, operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij:

a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti.

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti, për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të projektit sipas standarteve dhe praktikave më të mira botërore duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit. Menaxheret e projektit janë përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti implementimi, që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të sistemit, testimit, trajnimit dhe dokumentimit të projektit. Projekt menaxheri, duke marrë parasysh kompleksitetin e projektit, afatet kohore të kryerjes së shërbimit, shumëllojshmërinë e shërbimeve të kërkuara, do të sigurojë që çdo pikë e shërbimeve të kërkuara të kryhen me sukses dhe cilësi si edhe në kohë e afat sipas përcaktimeve të kësaj kontrate. Gjithashtu vlen të theksohet që me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantojë gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe prandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj).

b) Të paktën 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi në sisteme Operimi OS (operating system), të nivelit associate ose system administrator.

Argumentimi: Kjo kontratë ka për qëllim instalimin, konfigurimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin (update/patching) të sistemeve operative (OS) në kuadër të infrastrukturës virtuale të ngritur në mjedisin “Cloud”, për serverët e bazës së të dhënave (Database Server VM), serverët e aplikacionit (Application Server VM), si dhe mjediset e zhvillimit (Development Server/Client VM).

Për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të kësaj infrastrukture, është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë të paktën 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi në Sistemet Operative (OS), në nivelin Associate ose System Administrator.

Këta specialistë duhet të jenë në gjendje të:

- Kryejnë instalimin dhe konfigurimin profesional të sistemeve operative për secilën nga makinat virtuale të projektit,
- Aplikojnë në mënyrë të saktë patch-et dhe përditësimet e sigurisë të rekomanduara nga prodhuesi i OS,
- Monitorojnë dhe mirëmbajnë performancën dhe disponueshmërinë e mjedisit operativ,
- Reagojnë në kohë ndaj problemeve dhe ngarkesave në sistemin operativ për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit të aplikacioneve dhe bazës së të dhënave.

Prania e personelit të certifikuar është një garanci për zbatim korrekt, sipas praktikave më të mira të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe performancës, duke përbushur në mënyrë të plotë kërkesat funksionale dhe teknike të këtij projekti.

c) *Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi si Administratorë të Bazës së të Dhënave (DBA – Database Administrator)*

Argumentimi: Në mënyrë që kërkesat funksionale dhe teknike të përbushen sipas kushteve të kontratës. Për këtë arsye është kërkuar që personeli të jetë i certifikuar si Administrator Databaze dhe si zhvillues në bazat e të dhënave (database) për të në përmirësimin e efikasitetit dhe në garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit të bazës së të dhënave gjatë gjithë jetës së projektit.

Kjo kontratë ka për qëllim instalimin, konfigurimin dhe administrimin e bazës së të dhënave për sistemin financiar të Autoritetit Portual Durrës. Në mënyrë që kërkesat funksionale dhe teknike të përbushen sipas kushteve të kontratës, është thelbësore që operatori ekonomik të disponojë personel të specializuar dhe të certifikuar në administrimin dhe zhvillimin e bazave të të dhënave.

Për këtë arsye, kërkohet që operatori ekonomik të ketë minimumi 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi si Administratorë të Bazës së të Dhënave (DBA Instalimi dhe

konfigurimi i databazës të kryhet sipas standardeve të prodhuesit, duke garantuar performancë të lartë dhe siguri,

- Zhvillimet specifike në nivelin e databazës (p.sh. procedura të ruajtura, triggerë, optimizim queriesh) të kryhen nga një zhvillues i kualifikuar, për të përmbushur nevojat të personalizuar të projektit,
- Të sigurohet qëndrueshmëri dhe efikasitet i lartë operacional i databazës gjatë gjithë ciklit të jetës së projektit, përfshirë mirëmbajtjen, përditësimet dhe menaxhimin e performancës

Ky kriter është vendosur për të garantuar cilësi të lartë teknike dhe mbulim të plotë të të gjitha aspekteve të menaxhimit të bazës së të dhënave, që është një komponent kritik për funksionimin korrekt të sistemit financiar të projektuar.

d) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për infrastruktura e bazës së të dhënave “Database infrastructure” (Oracle Database 19c: RAC, ASM, and Grid Infrastructure Administrator).

Argumentim: Në mënyrë që kërkesat funksionale dhe teknike të përmbushen sipas kushteve të kontratës, është thelbësore që operatori ekonomik të disponojë personel të kualifikuar dhe të certifikuar në fushën e infrastrukturës së bazës së të dhënave. Për këtë arsye është kërkuar që të paktën 2 (dy) punonjës të jenë të certifikuar për “Database Infrastructure”.

Ky kriter është vendosur pasi projekti parashikon instalimin, përditësimin dhe migrimin e bazës së të dhënave në Cloud si dhe të elementeve kritikë të saj, siç janë *Grid Infrastructure* dhe *Automatic Storage Management (ASM)*. Këto komponentë janë thelbësorë për ndërtimin e një infrastrukture të qëndrueshme, të shkallëzueshme dhe me disponueshmëri të lartë (high availability).

Për të garantuar zbatimin e duhur të këtyre proceseve, si dhe për të siguruar që funksionalitetet e kërkuara nga projekti të implementohen në mënyrë të saktë, është e domosdoshme që operatori të ketë në dispozicion specialistë të certifikuar dhe me ekspertizë konkrete në administrimin e infrastrukturës së bazës së të dhënave. Kjo siguron jo vetëm implementim të saktë, por edhe mbështetje të qëndrueshme dhe të sigurt për sistemin gjatë gjithë ciklit të jetës së projektit.

e) Të paktën 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për Cloud Infrastructure, të nivelit Arkitekt.

Argumentim: Ky projekt ka për qëllim migrimin e sistemit të menaxhimit financiar të Autoritetit Portual Durrës “Oracle JDE” drejt një infrastrukture Cloud. Procesi përfshin jo vetëm transferimin teknik të të dhënave dhe aplikacioneve, por gjithashtu kërkon

projektim, konfigurim, optimizim dhe sigurim të një arkitekture Cloud të qëndrueshme, të shkallëzueshme dhe të sigurt.

Për këtë arsye, është thelbësore që operatori ekonomik të disponojë të paktën 3 (tre) punonjës të certifikuar në nivelin "Cloud Infrastructure Architect" nga prodhuesi i zgjidhjes Cloud. Certifikimi në nivel Arkitekt siguron që personeli të ketë aftësitë teknike dhe konceptuale për të projektuar një infrastrukturë Cloud që i përshtatet kërkesave specifike të sistemit financiar, përfshirë:

- Hartimin e arkitekturës së përgjithshme Cloud (compute, storage, networking, security),
- Zgjedhjen dhe konfigurimin e shërbimeve Cloud të duhura për performancë dhe efikasitet,
- Sigurimin e integritetit të suksesshëm me sistemet ekzistuese,
- Garantimin e vazhdimësisë së shërbimit,
- Përdorimin e praktikave më të mira për sigurinë dhe pajtueshmërinë.

Përfshirja e ekspertëve të certifikuar në këtë nivel është një garanci e drejtpërdrejtë për zbatimin korrekt dhe të suksesshëm të projektit, si dhe për sigurimin që funksionalitetet e kërkuara nga kontrata të realizohen me profesionalizëm të lartë dhe brenda standardeve ndërkombëtare të teknologjisë Cloud.

f) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për Cloud Database Migration, të nivelit Profesional.

Argumentim: Ky projekt ka për qëllim migrimin e bazës së të dhënave të sistemit të menaxhimit financiar të Autoritetit Portual Durrës drejt një infrastrukture Cloud, një proces teknikisht kompleks që kërkon planifikim të kujdesshëm, analiza të thelluara të strukturës ekzistuese të të dhënave, si dhe zbatim pa ndikuar në vazhdimësinë e shërbimit.

Për të garantuar që ky proces të realizohet në mënyrë të saktë, të sigurt dhe pa humbje të të dhënave, është thelbësore që operatori ekonomik të disponojë të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar në nivelin "Professional" për Cloud Database Migration nga prodhuesi i zgjidhjes Cloud.

Certifikimi profesional siguron që personeli ka:

- Njohuri të thelluara për metodologjitë e migrimit të bazave të të dhënave drejt Cloud,
- Eksperiencë në përdorimin e mjeteve dhe shërbimeve zyrtare për migrim të automatizuar dhe të kontrolluar,
- Aftësi për të menaxhuar riskun gjatë migrimit dhe për të ndjekur praktikat më të mira për siguri, performancë dhe integritet të të dhënave,

- Eksperiencë në testimin, validimin dhe optimizimin e bazës së të dhënave pas migrimit në ambientin Cloud.

Përfshirja e stafit të certifikuar në këtë proces është një parakusht për të garantuar zbatimin korrekt të projektit, si dhe për të siguruar që funksionalitetet kritike të sistemit financiar të mos ndërpriten dhe të përmirësohen në përputhje me kapacitetet që ofron infrastruktura Cloud.

g) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si programues. Certifikimet duhet të jenë të lëshuara nga prodhues të njohur si Oracle, Microsoft ose ekuivalent

Argumentim: Ky projekt ka për qëllim përmirësimin dhe personalizimin e sistemit të menaxhimit financiar në versionin JD Edwards 9.2, për të rritur automatizimin e proceseve dhe përmirësuar përvojën e përdoruesve fundorë. Për më tepër, projekti kërkon ndërveprim dhe integrim me sisteme të tjera ekzistuese, siç janë Mainsaver (për mirëmbajtjen e aseteve) dhe Payroll (për menaxhimin e pagave dhe burimeve njerëzore).

Për të realizuar me sukses këto ndërhyrje, kërkohen:

- Zhvillime të reja dhe modifikime në logjikën e sistemit, përmes objekteve të personalizuar (custom objects) në JD Edwards,
- Integritime përmes API-ve, shërbimeve web dhe mjetesh të tjera ndërveprimi midis sistemeve,
- Testim dhe implementim i zgjidhjeve të zhvilluara në një mjedis kompleks.

Për këtë arsye, është e domosdoshme që operatori ekonomik të ketë në dispozicion të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si programues, me certifikime të lëshuara nga prodhues të njohur si Oracle, Microsoft etj, që vërtetojnë njohuritë dhe përvojën e tyre në:

- Gjuhët e programimit të përdorura në ERP dhe sistemet mbështetëse (si SQL, PL/SQL, C/Java, Orchestrator, .NET etj.),
- Praktikat më të mira të zhvillimit të softuerit,
- Sigurinë e aplikacioneve dhe performancën e kodit.

Përfshirja e personelit të kualifikuar dhe të certifikuar siguron që zhvillimet dhe personalizimet e nevojshme të realizohen në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke garantuar stabilitetin, funksionalitetin dhe shkallëzueshmërinë e zgjidhjes për përdorim afatgjatë.

gj) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si specialist implementimi për menaxhim financiar, me fokus në modulin "General Ledger" (Libri Kryesor/i

Madh). Çertifikimet duhet të jenë të lëshuara nga prodhues të njohur si Oracle Microsoft ose ekuivalent.

Argumentim: Ky projekt ka për qëllim përmirësimin dhe modernizimin e sistemit të menaxhimit financiar të Autoritetit Portual Durrës, bazuar në platformën Oracle. Një nga komponentët thelbësorë të këtij sistemi është moduli “General Ledger” (Libri Kryesor), i cili përfaqëson bazën e të gjitha transaksioneve financiare dhe është përgjegjës për kontabilitetin e përgjithshëm dhe raportimin financiar.

Për të garantuar zbatim të saktë dhe të suksesshëm të funksionaliteteve që kërkon projekti, është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si specialist implementimi për menaxhim financiar, me fokus specifik në modulin General Ledger. Certifikimi duhet të jetë i lëshuar nga prodhues të njohur si Oracle, Microsoft ose ekuivalente.

Ky profil specialisti siguron që zgjidhja e re të jetë e optimizuar për proceset financiare të institucionit, duke rritur automatizimin, reduktuar gabimet manuale dhe mundësuar një raportim më të saktë dhe në kohë, në përputhje me nevojat dhe objektivat e Autoritetit Portual Durrës.

h) Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar si specialist implementimi për menaxhim financiar, me fokus në modulin "Payables" (Të Pagueshmet). Çertifikimet/Transkriptet duhet të jenë të lëshuara nga prodhues të njohur si Oracle, Microsoft ose ekuivalent.

Argumentim: Ky projekt ka për qëllim përmirësimin dhe modernizimin e sistemit të menaxhimit financiar të Autoritetit Portual Durrës, bazuar në platformën Oracle. Një nga komponentët më të rëndësishëm të këtij sistemi është moduli "Payables" (Të Pagueshmet), i cili menaxhon procesin e detyrimeve ndaj furnitorëve dhe transaksioneve të lidhura me pagesat.

Për të garantuar një zbatim të suksesshëm dhe në përputhje me standardet më të mira, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si specialist implementimi për menaxhim financiar, me fokus në modulin "Payables". Certifikimi duhet të jetë i lëshuar nga prodhues të njohur si Oracle, Microsoft ose ekuivalentë.

Ky profil specialisti siguron që zgjidhja e re të jetë e optimizuar për proceset financiare të institucionit, duke rritur automatizimin, reduktuar gabimet manuale dhe mundësuar një raportim më të saktë dhe në kohë, në përputhje me nevojat operationale dhe objektivat strategjike të Autoritetit Portual Durrës.

- i) *Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 1 (një) punonjës të certifikuar si "Implementation Specialist" për pajisjet Storage. Certifikimet/Transkriptet duhet të jenë të lëshuara nga prodhues të njohur si Oracle, Microsoft ose ekuivalent.***

Argumentim: Ky projekt ka për qëllim zhvillimin dhe menaxhimin e infrastrukturës Cloud, ku ndër komponentët kryesorë janë serveri i virtualizuar I aplikacionit dhe server i virtualizuar i bazës së të dhënave. Të dy këta komponentë varen drejtpërdrejt nga konfigurimi, performanca dhe disponueshmëria e pajisjeve Storage, të cilat përbëjnë bazën e infrastrukturës për ruajtjen dhe aksesin efikas të të dhënave.

Bazuar në këtë funksionalitet kritik, është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë minimumi 1 (një) punonjës të certifikuar si "Implementation Specialist" për pajisjet Storage, me certifikime të lëshuara nga prodhues të njohur si Oracle, Microsoft ose ekuivalentë.

Përfshirja e një specialisti të certifikuar në këtë fushë është një garanci për zbatim të sigurt dhe profesional të komponentëve të ruajtjes së të dhënave, të cilat janë jetike për funksionimin optimal të sistemit të menaxhimit financiar të Autoritetit Portual Durrës.

- j) *Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar si Arkitekt për Sigurinë Kibernetike (Cybersecurity Architect), në nivelin Ekspert. Certifikimet duhet të jenë të lëshuara nga prodhues të njohur si Cisco, Juniper ose ekuivalent.***

Argumentimi: Përfshirja e të paktën 1 (një) punonjësi të certifikuar si Arkitekt për Sigurinë Kibernetike, në nivelin Ekspert, është e domosdoshme për të garantuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ndaj sigurisë së informacionit dhe infrastrukturës IT.

Duke qenë se projekti përfshin implementimin e sistemeve kritike financiare në infrastrukturë Cloud, siguria kibernetike përbën një element thelbësor për mbrojtjen e të dhënave sensitive, kontrollin e aksesit, dhe mbrojtjen ndaj sulmeve të brendshme dhe të jashtme.

Një Arkitekt i certifikuar për Sigurinë Kibernetike në nivelin Ekspert ka:

- Njohuri të avancuara në identifikimin dhe analizën e rreziqeve të sigurisë kibernetike,
- Aftësi për të hartuar arkitektura të sigurta për rrjetin, sistemet dhe bazat e të dhënave në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare,
- Eksperiencë në përdorimin dhe konfigurimin e teknologjive të avancuara të sigurisë (firewall, IDS/IPS, VPN, segmentim rrjeti, enkriptim, etj.),
- Kapacitet për të zbatuar politika dhe mekanizma të vazhdueshëm të kontrollit dhe auditimit të sigurisë.

Përfshirja e një punonjësi të tillë rrit ndjeshëm aftësinë e operatorit për të parandaluar, detektuar dhe reaguar ndaj incidenteve të mundshme të sigurisë, duke kontribuar drejtpërdrejt në minimizimin e rrezikut dhe garantimin e integritetit, konfidencialitetit dhe disponueshmërisë së të dhënave dhe shërbimeve gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit.

k) Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar në nivelin Network Associate dhe si Specialist për Security Core. Çertifikimet duhet të jenë të lëshuara nga prodhues të njohur si Cisco, Juniper etj.

Argumentimi: Në mënyrë që kërkesat funksionale dhe teknike të përmbushen sipas kushteve të kontratës, është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivelin Network Associate dhe si Specialist për Security Core, me certifikime të lëshuara nga prodhues të njohur si Cisco, Juniper ose ekuivalentë.

Ky profil është thelbësor për të garantuar instalimin, konfigurimin dhe administrimin korrekt të pajisjeve të rrjetit, përfshirë routera dhe firewall, si dhe për të mundësuar krijimin e tuneleve të sigurt VPN, që do të shërbejnë për lidhjen e rrjetit të Autoritetit Portual Durrës me infrastrukturën Cloud ku do të strehohen sistemet kritike të këtij projekti.

Një profesionist i certifikuar në këto nivele:

- Ka njohuri të thelluara në konfigurimin e rrjetit dhe sigurisë së tij,
- Garanton implementimin e protokolleve të sigurt të komunikimit,
- Siguron ndarjen dhe mbrojtjen e trafikut të të dhënave ndërmjet mjedisit lokal dhe Cloud,
- Ndhmon në parandalimin e aksesit të paautorizuar dhe monitorimin e vazhdueshëm të pikave të ndjeshme të rrjetit.

Përfshirja e këtij profili ndihmon në rritjen e sigurisë, performancës dhe qëndrueshmërisë së komunikimit ndërmjet rrjeteve, duke kontribuar drejtpërdrejt në suksesin dhe integritetin e projektit.

2.3.6 Operoret ekonomik ofertues duhet të paraqesin Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike të ngarkuar në SPE nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listës. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- a. Emri i kompanisë prodhuese ose distributor i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit .Adresa dhe web-sit të sakta të kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar.
- b. Emërtimi i Katalogut të prodhuesit.

c. Nr.i faqes në katalog referuar Nr.Idetifikues të artikullit të ofruar sipas listës i shenuar me një shenjë dalluse.

d. Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin katalogët/broshurë për të gjithë mallrat që do të ofertohen. Katalogët duhet të jenë të përkthyer noterizuar si dhe të markuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6 germa c, si dhe në nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kërkesa për paraqitjen e ofertës teknike dhe katalogëve të paisjeve të sipërcituara i shërben Autoritetit Kontraktor për krijimin e një panorame të qartë mbi përputhshmërinë e produktit/eve dhe specifikimeve teknike të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesmarrës me produktin/tet dhe specifikimet teknike të kërkuara nga AK, pra qëllimi i këtij kriteri është vërtetimi nga ana e operatorit ekonomik se paisja që do të ofrohet i përmbush specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor duke bërë krahasimin ndërmjet tyre.

Shënim: Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim.

Shënim: Kërkesat për certifikimet e mësipërme duhet të vërtëtohen me Certifikatat leshuar nga prodhuesi ose Transkriptet përkatëse (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar).

Shënim: Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 mujorit të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave dhe kontratave të punës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në dokumentet mbi Specifikimet Teknike, bashkëlidhur dokumenteve standarte te tenderit, janë përcaktuar, duke i detajuar të gjithë pikat dhe kriteret e specifikimeve teknike, për kontratën e prokurimit me objekt “Upgrade Oracle JDE”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

KOMISIONI

I PERCAKTIMIT TE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PERLLOGARITJES SE VLERES SE KONTRATES